




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / PUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 2-D/DPK
 Nr. Prot. 01-3412/14
 Nr. i faq. 03
 Data 30.09.2014
 Broj stranica
 Date
 Nr. pages
 Date
 PRISHTINE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	30/09/2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ymer DRAGUSHA Drejtor i Prokurimit- Korporata Energjetike e Kosovës
CC:	z. Arben GJUKAJ Drejtor Menaxhues – Korporata Energjetike e Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: "Riparimi Kapital i Kaldajës dhe Qarqeve Rregulluese, Njësia A5 TC Kosova A"

I nderuar z. DRAGUSHA,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Riparimi Kapital i Kaldajës dhe Qarqeve Rregulluese, Njësia A5 TC Kosova A" me nr. të prokurimit: KEKC-14-063-511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me tenderin me titull "Riparimi Kapital i Kaldajës dhe Qarqeve Rregulluese, Njësia A5 TC Kosova A" me nr. të prokurimit: KEKC-14-063-511, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës – KEK.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës – KEK, bazuar në nevojën e sajë për Riparimin e Kaldajës dhe Qarqeve Rregulluese, ka paraparë aktivitetet prokurimi me *Procedurë të Hapur*. Autoriteti Kontraktues ka përgatitë *Njoftimin për Kontratë* me titull "Riparimi Kapital i Kaldajës dhe Qarqeve Rregulluese, Njësia A5 TC Kosova A" me nr. të prokurimit: KEKC-14-063-511, e cila më datë 12/06/2014 është publikuar në faqen elektronike të Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik – KRPP. Kjo procedurë në vetvete përmban tenderin të ndarë në dy LOTE. Në LOT 1 është paraparë: *Riparimi Kapital i Kaldajës, njësia A5*, ndërsa në LOT 2 është paraparë: *Riparimi Qarqeve Rregulluese njësia A5*.

Autoriteti Kontraktues pas zhvillimit të aktivitetit të prokurimit ka konstatuar se ka nxjerrë Operator Ekonomik fitues për aktivitetin e prokurimit titull "Riparimi Kapital i Kaldajës dhe Qarqeve Rregulluese, Njësia A5 TC Kosova A". Në Njoftimin për Dhënie të Kontratës të datës 05/08/2014, për LOT 1, është vendosur të shpërblehet me kontratë Operatori Ekonomik INTERING sh.p.k i cili është Operatori Ekonomik i përgjegjshëm me çmim më të ulët të ofertës. Çmimi i ofertuar nga ky Operator Ekonomik është 4.651.031,60 €, ndërsa çmimi më i lartë i Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm është: 5.731.608,14 €.

Në po të njëjtin Njoftimin për Dhënie të Kontratës të datës 05/08/2014, për LOT 2, është vendosur të shpërblehet me kontratë Operatori Ekonomik G3 INGINERING & INTERING i cili është Operatori Ekonomik i përgjegjshëm me çmim më të ulët të ofertës. Çmimi i ofertuar nga ky Operator Ekonomik është: 249.249,00 €, ndërsa çmimi më i lartë i Operatorit Ekonomik të përgjegjshëm është: 349.718,19 €. Për LOT 2, nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet tenderimi.

Operatori Ekonomik "EKOINVEST" si palë e pakënaqur me këtë aktivitet prokurimi, me datë 13/08/2014 ka paraqitur Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit për LOT 1. Ankesa e Operatorit Ekonomik "EKOINVEST" konsiston në atë, që Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 39 dhe 59, gjegjësisht në Formularët Standard dhe në Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, të ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë nr.04/L-042.

Autoriteti Kontraktues, Korporata Energjetike e Kosovës – KEK ka kërkuar interpretim ligjor nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik – KRPP në lidhje me pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues. Në kërkesën për interpretim, pyetja ka qenë e formuluar kështu, citojmë: "*OE i rekomanduar për kontratë ka ndërhyrë në Formularin e Tenderit – pjesën C, ku e ka vendosur Stemën e kompanisë, pastaj pikën 3 (vetëm numrin rendor) të formularit të tenderit e ka fshirë, ndërsa përmbajtja e pjesës (teksti) te pika 3 është" dhe keni shtruar pyetjen si në vijim, citoj: "A mund të konsiderohet kjo ndërhyrje nga ana e OE të rekomanduar për këtë kontratë si shkelje e dispozitave të LPP-së dhe a përbën shkelje substanciale e cila ndikon në përzgjedhjen e fituesit?" Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik – KRPP, më datë 03/09/2014 ka dhënë interpretim zyrtar në lidhje me këtë rast. Përgjigja e Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik – KRPP në lidhje me këtë rast është citojmë: "Bazuar në interpretimin e lartcekur, si dhe në dispozitat e këtij*

ligji dhe legjislacionit detyësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, KRPP mendon se: Vendosija e Logos nga Operatori Ekonomik në Formularin e Tenderit të tij sipas nenit 59 të këtij ligji mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale të tenderit në fjalë.

Më datë: 22/09/2014, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka nxjerrë Vendim (PSH.Nr.300/14) me të cilin Urdhërohet Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës që procedurën e prokurimit me titull "Riparimi Kapital i Kaldajës dhe Qarqeve Rregulluese, Njësia A5 TC Kosova A" LOT 1, me nr. të prokurimit: KEK/14/063/511, ta kthej në Ri-Vlerësim, dhe në afat prej 10 ditësh ta njoftoj me shkrim panelin shqyrtues lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Në raportin e Ri Vlerësimit të datës 26/09/2014, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë dy Operator Ekonomik të Përgjegjshëm.

Autoriteti Kontraktues, më datë 26/09/2014 në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik – KRPP ka bërë Njoftim për Dhënie të Kontratës ku është vendosur sërish që Operatori Ekonomik "INTERING" të shpërblehet me Kontratë për LOT 1

Agjencia Kundër Korrupsionit ka marrë pjesë në cilësinë e monitorimit të procesit të Ri Vlerësimit. Pas monitorimit të Ri Vlerësimit dhe përfundimin e tij, Agjencia ka konstatuar se procesi ka qenë i rregullt dhe nuk është vërejtur ndonjë diskriminim ose favorizim i ndonjë Operatori Ekonomik.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !